



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Qershor 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Muor

Korrik 2015

Gusht 2015

Shtator 2015

Nëntor 2015

Dhjetor 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2015

© Ministria e Financave, 2015

Drejtoria e Makroekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: marsed.harizi@financa.gov.al

eva.doda@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore


- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin qershor 2015 arriti në 118.1 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin qershor 2015 ishte 1.4 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin qershor 2015 ishte 125.61 lekë për dollarë dhe 140.82 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit qershor 2015 shënuan kuotat 1.45 për ato 12-mujore, 1.09 për 6-mujoret ,0.71 për qind për depozitat 3-mujore dhe 1.62 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.85 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.28 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,197,890.7 milionë lekë në muajin qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 3.9 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për tremujorin e parë të 2015 rezultoi me një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 55.9 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-qershor 2015 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 12.7 miliardë lekë, që do të thotë se rreth 50% më pak se planifikimi progresiv mujor (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 25.5 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2015, arritën në rreth 182.9 miliardë lekë ose afërsisht 96 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 195.6 miliardë lekë ose 90 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin qershor 2015 pësoi rënie prej 1.1 për qind krahasuar me muajin maj 2015, kur ky indeks shënonte rënie prej 1.6 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Gjithashtu gjatë muajit prill 2015, ky indeks shënoi rënie 0.5 për qind krahasuar me muajin mars 2015. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë kishin rënie me 0.7 për qind, rënie me 1.1 për qind dhe rënie me 0.6 për qind.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria me kontribut më të lartë në inflacionin e përgjithshëm në muajin qershor ishte “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.7%, duke kontribuar me +1.1 pikë përqindje. Rënia më e madhe gjatë muajit qershor u konstatua në kategorinë “Shëndeti” dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me përkatësisht -1.9 dhe -1.3 për qind. Pësha specifike relativisht e ulët që zënë këto grupe në shportën e mallrave të konsumit, bënë që ndryshimet e çmimeve për këto grupe të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit me nga 0.1 pikë përqindje.



Norma vjetore e inflacionit në muajin qershor arriti në 1.4 për qind. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2014 dhe janar 2015 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2014	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	1.5
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2014	1.8	2.0	1.5	1.4	1.7	0.7
2015						

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin qershor 2015, arriti në 140.82 lekë/euro, duke mbajtur të njëjtën vlerë me një muaj më parë. Në fund të muajit qershor, një euro u këmbye me 140.29 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin qershor 2015, arriti në 125.61 lekë/dollarë duke shënuar rënie me 0.5 për qind kundrejt muajit maj 2015. Në fund të muajit qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 125.57 lekë/dollarë.


Në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 22 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro në masën 0.5 për qind. Nënçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të Euros me Dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 0.892 dollarë/euro.




Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit qershor 2015, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.45 për qind, duke shënuar rënie me 0.14 pikë përqindje krahasuar me muajin maj 2015. Rënie për këtë muaj kanë shënuar gjithashtu normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 6-mujore dhe 3-mujore respektivisht me 0.04 dhe 0.18 pikë përqindje duke shënuar respektivisht në 1.09 dhe 0.71 për qind. Norma e interesit e depozitave me afat të maturimit një muaj shënoi rritje duke arritur nivelin 1.62 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore.




Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit qershor shënoi rritje me 0.87 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 8.85 për qind nga 7.98 për qind që ishte në muajin maj 2015. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi gjithashtu rritje me 0.42 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin qershor arriti në 9.28 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të huave me afate maturimi 12-mujor kanë shënuar rritje me 0.65 pikë përqindje, ndërsa ato me afat maturimi 6-mujor kanë pësuar rënie me 0.12 pikë përqindje.




Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit qershor 2015, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.29, 3.04 dhe 2.79 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie në *yield*-in e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore përkatësisht me 0.13, 0.07 dhe 0.11 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë.

4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për tremujorin e parë të 2015 regjistroi një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 55.9 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. Kontributin më të madh në të, e jep zëri i “Llogaria korrente” së bashku me nënzërat e saj, me -230.2 milionë euro, duke u ulur në vlerë absolute me 15.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. “Llogaria kapitale dhe financiare” për tremujorin e parë të 2015 rezultoi të jetë me një deficit prej 208.9 milionë euro ose gati 49% më e lartë se në tremujorin e parë të 2014.




Kompozicioni i llogarisë korrente prej -230.2 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për vitin 2014: (i) bilanci tregtar -468.7 mln euro, (ii) shërbime neto 103.1 mln euro, (iii) të ardhura neto -49.4 mln euro, (iv) transferta neto 184.9 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit qershor 2015, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 66.4 miliardë lekë krahasuar me muajin qershor të vitit 2014. Kjo rritje ka ardhur më së shumti si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 32 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 33 miliardë lekë.





Në muajin qershor 2015, sistemi bankar rezulton me një rritje prej 55.7 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin maj 2015. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 1,564.5 milionë lekë.



6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin qershor 2015 arriti në 552,494.3 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me qershor 2014 shënoi rritje me vlerë 4,123 miliardë lekë, pra rritje prej rreth 0.8 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 56.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 313,418 milionë lekë. Gjatë muajit qershor 2015, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 65.4 për qind ose 361,445 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 27.95 për qind ose 154,416 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.93 dhe 1.55 për qind apo 27,241 dhe 8,547 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin qershor 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 54.35 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.87 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare” me 9.83 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.86 për qind dhe rreth 23.43 për qind.



7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin qershor 2015 shënoi rritje prej 0.34 për qind krahasuar me muajin paraardhës maj 2015. Kjo ofertë arriti në rreth 1,197,890.7 milionë lekë në fund të muajit qershor 2015, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin maj 2015 prej 3.9 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin qershor 2015, kanë pësuar rënie prej 4,428.4 milionë lekë në krahasim me muajin qershor 2014. Depozitat në valutë gjatë muajit qershor 2015 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.4 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 87.9 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit qershor 2015, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.9 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.5 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.6 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.4 për qind dhe rreth 12.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 87.9 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 845,975.5 milionë lekë) të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (105,245.0 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (15,263.9 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (8,507.3 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,403.5 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit qershor 2015, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi një rritje prej 498,841.2 milionë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në valutë me rreth 1,799.3 milionë dhe të depozitave në lekë me rreth 2,983.8 milionë lekë.

Fig-14




Përberja e depozitave Qershor 2015

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-qershor 2015 janë mbledhur rreth 182.9 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 195.6 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 162.2 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 20.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 60% janë financim i brendshëm.



Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 120.4 miliardë lekë (ose rreth 90% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 6.7 miliardë lekë (ose rreth 88% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 34.9 miliardë lekë (ose rreth 104% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 17 miliardë lekë (ose rreth 132% e planit të periudhës).

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 96% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 90% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 94% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 81% të tij.

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 162.2 miliardë lekë, 35 miliardë lekë (22% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 17.2 miliardë lekë (11%) për interesat, 17.3 miliardë lekë (11%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 810 milionë lekë (0.5%) për subvencione, 66 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 16.3 miliardë lekë (10%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 9.6 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 46% (shpenzime personeli), 35% (shpenzime për interesat), 44% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 46% (subvencione), 46% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 40% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 40% shpenzimet e tjera) përkundrajt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 43%, ndërsa financimi i huaj është 22% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-qershor 2015 ishin rreth 182.9 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 162.1 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 17 miliardë lekë.

Tab - 2 Të ardhurat gjatë periudhës janar-qershor 2015 (mld Lekë)

Burimi	qer'15	qer'14	Ndryshimi në (%)
TVSH (VAT)	58	61.2	-5.2
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	13.6	11.2	21.4
Taksa doganore (Custom Tax)	2.6	2.8	-7.1
Taksat nacionale (National Tax)	15.3	15.8	-3.2
Akcizat (Excise)	17.4	16.3	6.7
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	13.5	13.2	2.3

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: qershor – 2015;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: June – 2015;

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 12.7 miliardë lekë, për periudhën janar-qershor 2015, u mbështet nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 107% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishte huaja afatgjatë mjeti kryesor (rreth 32% të totalit të deficitit).

Për muajin qershor 2015, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 30,846 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 33,571 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin qershor 2015, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 28.4 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 30.2 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 2.9 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1		Indeksi i Çmimeve të Konsumit Consumer Price Index																	
		Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)					
Muaji	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
Janar	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	1.4	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	January
Shkurt	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	February
Mars	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4	0.71	1.00	0.80	0.77	0.90	1.4	4.1	4.3	1.0	2.4	2.2	2.2	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	0.42	0.60	0.58	0.55	0.53	0.9	3.7	4.1	1.6	2.3	1.7	2.3	April
Maj	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	0.10	0.26	0.32	0.24	0.20	0.2	3.3	4.2	1.9	2.1	1.6	1.8	May
Qershor	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.04	0.04	0.12	0.15	0.05	-0.7	3.2	3.9	2.2	2.3	1.5	1.4	June
Korrik	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6		-0.10	-0.07	0.08	-0.03	-0.04		3.4	3.6	2.7	1.6	1.8		July
Gusht	0.8	0.3	0.4	-0.1	0.1		0.01	-0.02	0.12	-0.04	-0.03		3.5	3.1	2.8	1.2	2.0		August
Shtator	0.7	0.4	0.2	0.8	0.3		0.09	0.02	0.13	0.06	0.01		3.4	2.8	2.6	1.7	1.5		September
Tetor	0.2	0.4	0.2	0.1	0.1		0.10	0.06	0.14	0.05	0.02		3.0	3.0	2.4	1.7	1.4		October
Nëntor	0.2	0.1	0.2	-0.5	-0.2		0.11	0.06	0.14	0.01	0.00		2.8	2.9	2.5	1.0	1.7		November
Dhjetor	2.2	1.0	0.9	1.7	0.7		0.28	0.14	0.20	0.15	0.06		3.4	1.7	2.4	1.9	0.7		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source: INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2		Kursi i këmbimit Exchange rat Lekë për njësi të monedhës së huaj (Lek per unit of foreign currency)										Currency	
		2010	2011	2012	2013	2014	2015						
Monedha						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor		
<i>Mesatarja e periudhës</i>												<i>Average of period</i>	
USD		103.94	100.90	108.18	105.67	113.64	120.73	123.46	129.66	129.97	126.19	125.61	USD
EURO		137.79	140.33	139.04	140.27	140.11	140.04	140.23	140.41	140.26	140.82	140.82	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>													<i>In the end of period</i>
USD		104.00	107.54	105.85	101.86	115.23	123.35	124.96	130.63	125.61	128.48	125.57	USD
EURO		138.77	138.93	139.59	140.20	140.14	139.72	140.36	140.34	140.53	140.98	140.29	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2010	2011	2012	2013	2014	2015						In percent	
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun		
Norma e depozitave													Deposits rates
12-M	6.07	5.87	5.38	4.17	1.51	1.42	1.57	1.46	1.45	1.59	1.45	1.45	12-M
6-M	5.16	4.87	4.50	3.40	1.16	1.22	1.25	1.08	1.05	1.13	1.09	1.09	6-M
3-M	4.42	4.22	3.83	2.72	0.83	0.77	0.90	0.72	0.79	0.89	0.71	0.71	3-M
1-M	4.70	4.39	3.62	2.79	1.47	1.52	1.51	1.42	1.59	1.59	1.62	1.62	1-M
Norma e huasë													Lending rates
12-M	11.52	11.17	10.28	9.52	7.00	7.76	7.36	8.74	8.14	7.98	8.85	8.85	12-M
6-M	11.69	12.28	10.61	9.59	8.18	8.21	8.17	9.30	10.18	8.86	9.28	9.28	6-M
Norma e letrave me vlerë													Securities rates
Bono thesari 1/													Treasury bills 1/
3-M	5.29	5.31	5.03	3.40	3.15	3.23	3.19	3.11	3.00	2.90	2.79	2.79	3-M
6-M	6.41	6.23	5.65	3.54	3.16	3.23	3.23	3.25	3.14	3.11	3.04	3.04	6-M
12-M	7.09	6.95	6.37	3.66	3.33	3.50	3.58	3.59	3.50	3.42	3.29	3.29	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	25,703	51,769	87,362	121,753	152,095	182,941	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	256	915	1,703	2,587	3,450	3,764	Grants
II.	Të ardhura tatimore	22,778	46,710	76,564	106,210	133,775	162,127	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	15,669	33,479	56,568	77,104	98,394	120,445	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	9,370	18,365	26,968	36,914	47,151	57,956	V. A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	588	2,243	8,915	10,279	11,778	13,595	Profit Tax
3	Akcizat	1,779	4,359	7,056	10,598	13,904	17,407	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	1,940	4,018	6,141	8,607	11,252	13,510	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	1,643	3,750	6,213	9,019	12,170	15,336	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	349	744	1,275	1,687	2,139	2,641	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pusstet/ Vendor	549	1,386	2,512	4,972	5,782	6,732	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	388	935	1,921	2,101	2,399	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	14	276	362	628	729	839	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	340	722	1,215	2,423	2,952	3,494	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	6,560	11,845	17,485	24,134	29,600	34,951	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	5,584	10,003	14,577	20,077	24,642	29,153	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	837	1,534	2,412	3,374	4,071	4,768	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	139	308	496	683	886	1,030	Revenues for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,669	4,144	9,095	12,956	14,870	17,050	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				951	951	951	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,234	3,321	7,843	9,800	10,884	12,444	Income of budgetary institutions
3	Dividenti				444	449	461	Divident
4	Tarifat shërbimeve	214	375	476	599	972	1,199	Tariffs on services
5	Të tjera	221	448	776	1,162	1,614	1,995	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	22,913	57,254	91,124	124,660	162,038	195,609	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	21,098	46,431	74,883	102,854	131,965	162,167	Current Expenditures
I.1	Personell	5,474	11,300	17,303	23,115	29,084	35,027	Personnel expenditures
1	Paga	4,764	9,766	14,873	19,905	25,021	30,135	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	710	1,534	2,430	3,210	4,063	4,892	Social insurance contributions
I.2	Interesat	2,984	6,294	8,937	11,822	14,499	17,184	Interest
1	Të Brendshme	2,606	5,354	7,475	9,693	11,965	14,141	Domestic
2	Të Huaja	378	940	1,462	2,129	2,534	3,043	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	882	2,927	6,445	9,491	12,469	17,274	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	53	122	301	363	628	810	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	9,875	20,382	31,634	42,800	54,270	65,979	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	7,874	15,911	24,449	32,938	41,522	50,586	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	2,001	4,471	6,965	9,631	12,517	15,162	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve			220	231	231	231	Expenditures for Owners Compensation
I.7	Shpenzime për Buxhetin Vendor	1,127	3,239	5,664	8,722	12,467	16,256	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	703	2,167	4,599	6,541	8,548	9,637	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	116	174	229	280	330	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	655	2,080	3,714	5,506	7,403	7,918	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-11	-29	711	806	865	1,389	Compensation for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	1,584	3,569	8,830	14,215	17,953	20,881	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	102	925	4,568	8,275	10,508	12,528	Domestically financed
2	Financimi Huaj	1,482	2,644	4,262	5,940	7,445	8,353	Foreign financed
IV.	Detyrimet e prapambetura	231	7,254	7,411	7,591	12,120	12,561	
1	Detyrimet e infrastruktures	211	4,668	4,762	4,886	5,242	5,299	
2	Detyrimet tatimore					4,168	4,481	
3	Te tjera	20	2,586	2,649	2,705	2,710	2,781	
	DEFICITI	2,790	-5,485	-3,762	-2,907	-9,943	-12,668	CASH BALANCE
	FINANCIMI DEFICITIT	-2,790	5,485	3,762	2,907	9,943	12,668	CASH BALANCE FINANCING
	Brendshëm	-3,845	-3,528	-5,280	-1,237	1,156	5,335	Domestic
	Të ardhura nga privatizimi	4	28	77	83	242	249	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	4,868	5,441	9,153	12,300	11,716	13,516	Domestic new borrowing (net)
	Nacionale	4,877	5,452	9,072	12,227	11,624	13,426	Other
	Lokale	-9	-11	81	73	92	90	Foreign
	Të tjera	-8,717	-8,995	-14,510	-13,620	-10,802	-8,430	Other
	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-8,020	-6,497	-10,828	-9,941	-6,325	-5,173	Government deposits into the Central Bank
	Të tjera	-697	-2,496	-3,679	-3,681	-4,478	-3,259	Other
	Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	218	-735	-1,062	-1,456	Deposits of Social and Health insurance
	Mjete në ruajtje	-25	-210	1,218	-210	-468	-311	Preservation stock
	Nënhua	58	118	118	394	442	451	On-Loan Principal
	Detyrim ndaj ISSH	2,785	2,525	1,982	753	486	-564	Liabilities to SSI
	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-56	108	-79	102	123	216	Other-Float
	I huaj	1,055	9,011	9,042	4,144	8,787	7,333	Foreign
	Hua afatgjatë(e marrë)	1,223	1,771	2,840	3,298	3,739	4,038	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	406	413	845	981	983	1,059	
	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-34	-254	96	301	597	Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-839	-1,646	-2,464	-8,170	-9,281	-11,330	Repayments
	Mbështetje Buxhetore	665	8920	8920	8920	14028	14028	Budgetary Support

Tab - 5

Tabela e investimeve 2015

Table of investments 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	
Financim i brendshëm	102	925	4,568	8,275	10,508	12,528	Domestic financing
<i>Në %</i>	6.44	25.93	51.73	58.21	58.53	60.00	<i>In %</i>
Financim i huaj	1,482	2,644	4,262	5,940	7,445	8,353	Foreign financing
<i>Në %</i>	93.56	74.07	48.27	41.79	41.47	40.00	<i>In %</i>
Totali	1,584	3,569	8,830	14,215	17,953	20,881	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2015 (CUSTOMS REVENUES 2015)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	
Taksë doganore	349	744	1,275	1,687	2,255	2,641	Customs Duties
TVSH	5,805	12,386	20,043	27,489	38,183	43,564	V.A.T
Akcizë	1,779	4,359	7,056	10,598	12,499	17,407	Excises
Të tjera	209	412	652	946	3,450	1,908	Others
Renta Minerare	201	396	626	911	3,099	1,855	
TOTALI	8,142	17,901	29,026	40,720	56,387	65,520	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2014 (TAX REVENUE)

TVSH	4,091	6,503	7,451	9,424	12,177	14,392	V.A.T
Akciza	0	0	0	0	1	0	Excises
Tatim mbi fitimin	393	2,051	8,715	10,279	9,477	13,595	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,919	3,997	6,120	8,607	10,902	13,510	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	1,225	3,128	5,351	8,073	9,419	13,428	National taxes
TOTALI	7,628	15,679	27,637	36,383	41,976	54,925	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	15,770	33,580	56,663	77,103	98,363	120,445	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2015

The Deficit and Its Financing for 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qersh June	
TË ARDHURAT	25,703	51,769	87,362	121,753	152,095	182,941	REVENUE
SHPENZIMET	22,913	57,254	91,124	124,660	162,038	195,609	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,790	-5,485	-3,762	-2,907	-9,943	-12,668	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,790	5,485	3,762	2,907	9,943	12,668	FINANCING
Financimi i brendshëm	-3,845	-3,526	-5,280	-1,237	1,156	5,335	Domestic
a. Bono Thesari Neto	793	2,101	2,116	-790	7,574	-5,754	Treasury bills
b. Obligacione	3,000	2,606	6,544	13,017	8,027	19,180	Bonds
c. Ndryshimi i gjëndjes së arkës	-5,762	-5,278	-10,610	-10,676	-7,387	-6,629	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-8,020	-6,497	-10,828	-9,941	-6,325	-5,173	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	218	-735	-1,062	-1,456	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	-25	-210	1,218	-210	-468	-311	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	4	28	77	83	242	249	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-2,930	-3,505	-5,115	-2,736	-5,028	-4,122	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-9	-11	81	73	92	90	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	1,055	9,011	9,042	4,144	8,787	7,333	Foreing
a. Hua afatgjatë	1,223	1,771	2,840	3,298	3,739	4,038	Long-term foreign borrowing (gross)
nga e cila: nën-hua	406	413	845	981	983	1,059	
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	6	-34	-254	96	301	597	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-839	-1,646	-2,464	-8,170	-9,281	-11,330	Repayments
Mbeshtetje Buxhetore	665	8,920	8,920	8,920	14,028	14,028	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 8

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	6M_I 2014	3M_III 2014	9M_2014	3M_IV 2014	Viti 2014	3M_I 2015	
Llogaria korente	-1,026.70	-271.50	-341.00	-612.50	-313.20	-925.70	-377.50	-1,303.20	-230.20	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-426.20	-511.40	-937.60	-560.70	-1,498.30	-638.30	-2,136.60	-468.70	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	212.40	264.90	477.30	228.80	706.10	219.20	925.30	169.90	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-638.60	-776.30	-1,414.90	-789.50	-2,204.40	-857.50	-3,061.90	-638.60	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	30.00	38.10	68.10	97.90	166.00	102.40	268.40	103.00	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	396.40	487.10	883.50	610.00	1,493.50	538.00	2,031.50	454.50	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	366.40	449.00	815.40	512.10	1,327.50	435.60	1,763.10	351.50	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-20.60	-43.30	-63.90	-48.70	-112.60	-47.00	-159.60	-49.40	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	28.70	25.80	54.50	28.30	82.80	27.80	110.60	22.90	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-49.30	-69.10	-118.40	-77.00	-195.40	-74.80	-270.20	-72.30	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	145.30	175.60	320.90	198.30	519.20	205.40	724.60	184.90	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	172.60	204.40	377.00	230.60	607.60	244.20	851.80	216.10	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	20.70	-27.30	-28.80	-56.10	-32.30	-88.40	-38.80	-127.20	-31.20	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	22.50	22.40	44.90	20.70	65.60	21.10	86.70	26.00	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-161.90	-184.20	-346.10	-363.00	-709.10	-247.20	-956.30	-234.90	Financial Account
Investime direkte	893.10	-168.00	-150.40	-318.40	-253.50	-571.90	-229.40	-801.30	-257.90	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	14.50	14.00	28.50	-12.40	16.10	104.70	120.80	-94.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-8.40	-47.80	-56.20	-97.10	-153.30	-122.50	-275.80	117.10	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	49.90	104.20	154.10	86.40	240.50	70.50	311.00	25.10	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	-37.20	-30.20	-67.40	156.90	89.50	-38.70	50.80	55.90	Overall Balance
Rezervat	-104.40	-40.30	22.50	-17.80	154.00	136.20	-39.00	97.20	111.80	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	-3.20	52.80	49.60	-2.90	46.70	-0.30	46.40	55.90	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 9 MJETET VALUTORE NETO
Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015					Qershor Jun	Millions of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May		
Mjetet valutore neto	252,827.9	255,657.9	266,540.0	274198.1	292,098.3	304,919.7	310,980.2	314,436.3	303,394.3	303,895.0	305,459.8	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	274,628.2	276,475.7	288,142.1	294111.3	318,940.2	332,347.1	346,806.1	349,332.6	337,586.5	346,592.2	347,885.6	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	21,800.3	20,817.8	21,602.1	19913.2	26,841.9	27,427.4	35,825.9	34,896.3	34,192.3	42,696.9	42,425.8	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	72,244.4	84,492.3	78,858.1	67841.8	82,525.1	75,655.1	81,729.0	77,731.6	82,786.8	86,758.9	95,068.4	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	57,937.1	57,098.0	55,145.6	44503.1	55,198.3	45,767.4	54,418.0	47,350.5	49,173.2	59,472.9	61,702.6	Net Calims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	66,928.8	67,590.8	68,057.8	66768.8	71,831.3	71,633.6	78,940.0	78,059.0	78,001.2	84,924.0	85,509.0	Minus: Due to Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	8,991.7	10,492.8	12,912.2	22265.7	16,633.0	25,866.2	24,522.0	30,708.5	28,828.0	25,451.1	23,806.4	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21502.9	25,547.8	28,110.7	25,602.4	28,615.3	31,897.3	25,564.1	31,664.9	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	37.3	41.5	41.4	41.9	-	-	-	Claims on other resident sectors
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,771.7	1,908.5	1,911.7	1835.8	1,741.7	1,735.5	1,730.2	1,724.0	1,716.3	1,707.2	1,700.9	Monetary Base
Baza Monetare	283,453.5	289,809.0	297,721.9	308073.7	332,899.3	331,487.2	342,191.5	338,448.3	336,003.7	338,145.6	351,065.5	Deposits not included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	625.3	2,432.0	1,125.1	787.9	1,093.8	957.1	1,039.3	955.5	965.0	863.7	856.9	Loans
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Other accounts payable
Llogari të pagueshme	797.9	901.1	1,306.1	1309.8	14.8	26.1	8.9	29.2	17.9	10.2	34.2	Other items net
Të tjera neto	-12,051.3	-12,984.4	-14,702.6	-14102.8	-15,170.5	-15,733.5	-15,983.5	-16,017.0	-15,980.9	-15,994.4	-15,761.1	Shares and other equity
Aksione	52,246.7	59,992.0	59,947.5	45,971.3	55,786.1	63,837.9	65,515.9	68,752.0	65,175.3	67,629.1	64,332.8	Source : Bank of Albania

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

.2

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015					Qershor Jun	Million of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May		
Total i kredisë	483,044.8	541,899.9	554,732.2	547927.6	559,986.7	557,666.5	556,699.4	557,402.4	556,617.8	559,909.4	552,494.3	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	-	147.20	193.9	256	777.7	769.0	767.3	862.6	855.4	875.4	878.6	Credits to local Government
Në lekë	-	147.20	193.9	256	777.7	769.0	767.3	862.6	855.4	875.4	878.6	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	9,373.9	18,678.5	23,780.7	24961	27,328.1	28,250.7	27,330.6	28,188.9	26,958.5	26,931.0	27,241.3	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	5,022.9	8,446.2	18,474.3	20251.4	22,402.3	23,334.7	22,415.7	23,730.6	22,538.3	23,075.0	23,493.1	in Lek
Në valutë	4,351.0	10,232.3	5,306.4	4709.6	4,925.8	4,916.0	4,914.9	4,458.3	4,420.2	3,856.0	3,748.2	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	315,879.1	364,373.9	370,993.0	363541.2	372,166.5	368,219.1	367,939.3	365,598.1	366,626.0	369,380.0	361,444.6	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	83,234.9	108,321.7	121,808.7	122944.7	129,429.4	126,951.2	127,328.3	128,097.4	129,045.6	130,371.0	129,944.4	in Lek
Në valutë	232,644.2	256,052.2	249,184.3	240596.5	242,737.1	241,267.9	240,611.0	237,500.7	237,580.4	239,009.0	231,500.2	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	8,704.5	9,841.9	10,162.9	9578.2	8,270.3	8,237.2	8,041.6	7,950.5	8,185.3	8,131.0	8,514.0	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	2,957.0	3,364.2	4,031.7	4238.4	3,436.9	3,233.8	3,165.9	3,295.6	3,369.8	3,497.0	3,798.9	in Lek
Në valute	5,747.5	6,477.7	6,131.2	5339.8	4,833.4	5,003.4	4,875.7	4,654.9	4,815.5	4,634.0	4,715.1	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	149,087.3	148,858.4	149,601.7	149591.2	151,444.1	152,190.5	152,620.6	154,802.3	153,992.6	154,592.0	154,415.8	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	65,897.5	68,499.9	70,614.1	72242.5	77,396.7	77,699.1	77,729.1	79,643.7	79,486.4	79,869.0	80,994.9	in Lek
Në valutë	83,189.8	80,358.5	78,987.6	77348.7	74,047.4	74,491.4	74,891.5	75,158.6	74,506.2	74,723.0	73,420.9	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015						Millions of LEK End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	
Baza monetare	283,453.5	289,809.5	297,721.9	308,073.7	332,899.3	331,487.2	342,191.5	338,448.3	336,003.7	338,145.6	351,065.5	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	-0.5	5.4	2.7	3.5	8.1	8.6	12.7	11.8	8.8	9.6	13.8	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	195,059.0	194,923.4	192,705.1	198,892.7	217,665.6	215,043.4	217,290.4	216,414.7	217,266.1	222,645.4	226,486.1	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	-6.7	-0.1	-1.1	3.2	9.4	10.3	11.9	11.8	12.3	14.5	14.7	Y/Y change in %
Depozita	785,225	875,230	930,703	950,088.4	977,420	972,965.8	974,884.4	974,357.7	975,745.4	977,873.4	658,203.9	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	18.5	10.5	6.3	2.1	2.9	2.4	2.6	2.6	2.7	2.9	-30.7	Y/Y change in %
Agregati M1	275,427.3	276,898.3	281,246.6	295,876.5	353,321.7	346,305.1	349,688.4	347,957.9	350,671.9	358,825.4	363,300.7	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	-3.2	0.5	1.6	5.2	19.4	18.6	19.7	18.4	18.4	19.4	18.2	Y/Y change in %
Agregati M2	604,517.3	647,007.8	669,577.1	693,172.2	722,356.7	714,347.9	717,983.0	715,949.6	717,583.8	724,470.3	725,327.2	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	4.6	7.0	3.5	3.5	4.2	3.9	4.4	4.6	4.6	5.4	4.8	Y/Y change in %
Agregati M3	980,283.9	1,070,153.7	1,123,407.8	1,148,980.9	1,195,086.3	1,188,009.1	1,192,174.7	1,190,772.3	1,193,011.4	1,198,833.1	1,197,890.7	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	12.5	9.2	5.0	2.3	4.0	3.8	4.5	4.1	4.5	4.8	3.9	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare												Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	252,827.8	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	304,919.7	310,980.2	314,436.3	303,394.3	303,895.3	305,459.8	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	72,244.3	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	75,655.1	81,729.0	77,731.6	82,786.8	86,758.9	95,068.4	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	57,937.1	57,098.1	55,145.6	44,503.1	55,198.3	45,767.4	54,418.0	47,350.5	49,173.2	59,472.9	61,702.6	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	28,110.7	25,602.4	28,615.3	31,897.3	84,924.0	85,509.0	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 12 DEPOZITAT
Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015						Millions of Leks End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	
Në lekë	409,459	452,085	476,872	494,279.5	504,691	499,305	500,693	499,535	500,318	502,511	498,841	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	80,369	81,975	88,541	96,983.9	135,656	131,262	132,398	131,543	133,406	136,180	136,815	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	948.1	1,157.4	1,059.7	1,305.0	2,047.5	1,391.4	1,392.3	1,466.1	1,191.6	1,363.9	1,294.3	Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,134.0	7,303.4	7,168.0	6,108.2	9,799.5	8,354.8	9,270.5	7,544.2	7,280.4	7,182.4	7,060.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	920.6	532.5	1,789.2	937.0	1,919.8	1,274.1	856.7	1,156.4	988.8	1,526.2	1,158.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	22,505.0	20,681.5	24,716.6	24,244.0	38,198.6	35,599.7	34,977.6	34,321.7	33,825.8	35,438.5	34,761.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	48,860.8	52,300.1	53,807.9	64,389.7	83,690.6	84,641.7	85,900.9	87,054.9	90,119.1	90,669.1	92,540.0	Other resident sectors
Depozita të tjera	329,090	370,110	388,331	397,295.6	369,035	368,043	368,295	367,992	366,912	366,331	362,027	Other deposits
Qeveria lokale	55.1	109.6	19.4	57.1	7.8	18.8	15.8	15.9	17.2	27.3	27.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,054.3	2,608.9	1,715.4	1,257.8	1,167.9	1,083.2	585.6	590.1	606.0	931.0	1,030.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,773.4	1,423.5	2,224.4	2,556.5	1,730.1	1,893.8	1,762.4	2,555.6	4,584.9	3,169.5	2,750.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	8,316.8	11,292.5	10,954.1	14,523.4	11,772.0	11,497.7	13,457.9	14,509.0	13,366.9	13,459.5	12,474.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	315,890.5	354,675.1	373,417.3	378,900.8	354,357.3	353,549.3	352,473.0	350,321.1	348,337.1	348,743.3	345,743.3	Other resident sectors
Në valutë	375,767	423,146	453,831	455,808.9	472,729	473,661	474,192	474,823	475,428	475,363	159,363	In foreign currency
Qeveria lokale	493.0	280.5	44.5	372.6	231.3	102.8	120.5	63.7	88.9	93.9	81.3	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,201.0	5,242.2	4,011.2	4,486.2	7,099.6	7,612.5	8,010.5	7,518.9	7,134.0	5,951.2	4,830.8	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	8,572.0	6,022.3	6,303.3	6,673.1	4,872.9	4,428.5	4,603.1	4,641.7	4,824.2	4,446.0	1,004.2	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	57,382.9	54,418.4	46,867.5	49,382.3	55,834.3	56,871.4	56,034.9	55,310.7	58,514.9	58,852.8	46,903.8	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	303,117.7	357,182.4	396,604.2	394,894.7	404,691.2	404,646.1	405,422.7	407,287.7	404,865.6	406,018.8	106,542.6	Other resident sectors
Total	785,225	875,230	930,703	950,088.4	977,420	972,965.8	974,884.4	974,357.7	975,745.4	977,873.4	658,203.9	Total
Qeveria lokale	1,496.2	1,547.5	1,123.6	1,735	2,286.6	1,513.0	1,528.6	1,545.7	1,297.7	1,485.1	1,403.5	Local governments
Korporata jofinanciare publike	16,389.3	15,154.5	12,894.6	11,852.2	18,067.0	17,050.5	17,866.6	15,653.2	15,020.4	14,064.6	12,921.4	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,266.0	7,978.3	10,316.9	10,166.6	8,522.8	7,596.4	7,222.2	8,353.7	10,397.9	9,141.7	4,913.6	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,204.7	86,392.4	82,538.2	88,149.7	105,804.9	103,968.8	104,470.4	104,141.4	105,707.6	107,750.8	94,139.5	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	667,869.0	764,157.6	823,829.4	838,185.2	842,739.1	842,837.1	843,796.6	844,663.7	843,321.8	845,431.2	544,825.9	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH
 Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015						Millions of Lek End of period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	
AKTIVET	368,032	384,581	394,834	398,814	433,878	450,092	469,195	473,891	465,272	474,884	482,605	ASSET
Total	50,480	48,572	48,288	40,652	51,880	61,185	69,219	69,570	67,710	74,068	76,253	Total
Mbajtjet e SDR	8,126.9	8,226.5	8,789.7	10,508.0	19,299.7	20,589	28,614	29,255	28,371	33,915	33,301	SDR holdings
Arka në valutë	647.0	59.8	67.5	57.3	56.2	21.4	138.9	30.7	134.7	15.4	13.5	Foreign currency
Depozitat	41,705.7	40,286	39,431.1	30,086.2	32,524.0	40,574.3	40,466.6	40,284.8	39,204.1	40,137.8	42,937.7	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	280,301	284,210	294,007	308,387	320,745	324,262	329,749	332,379	322,846	324,268	324,077	Securities other than shares
Jorezident	215,901.8	219,718.8	229,313.1	243,178.6	256,796.7	260,519	266,085	269,169	259,690	261,157	260,361	nonresidents
Qeveria qendrore	64,399.2	64,490.8	64,694.1	65,208.4	63,947.9	63,742.8	63,663.5	63,210.0	63,156.0	63,110.7	63,716.1	central government
Huatë	14,302	27,388	23,707	23,333	27,286	29,843	27,329	30,335	33,609	27,268	33,362	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,534.8	25,485.4	21,800.2	21,502.3	25,547.8	28,111	25,602	28,615	31,897	25,564	31,665	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,767.3	1,902.8	1,906.5	1,830.9	1,738.5	1,732.0	1,726.2	1,719.3	1,711.2	1,704.2	1,697.5	Other resident sectors
Derivatet financiare	81.4	35.3	14.2	31.5	17.4	20.8	35.1	34.5	51.8	61.4	40.2	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	10,748.3	11,295.9	14,129.2	11,994.1	18,197.8	18,584.3	26,811.9	25,478.7	25,003.1	33,151.0	33,039.7	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	12,119.1	13,080.0	14,688.0	14,416.4	15,752.1	16,198.1	16,051.5	16,094.2	16,052.9	16,067.9	15,833.2	Nonfinancial assets
DETYRIMET	368,032	384,581	394,834	398,814	433,878	449,770	469,195	473,891	465,272	474,884	312,232	LIABILITIES
Total	202,644	203,009	201,086	208,042	226,588	224,140	226,296	226,418	228,890	232,903	237,241	Total
Para në qarkullim	202,386.7	202,906.6	200,898.7	207,792.7	226,434.1	224,010	226,134	225,390	225,811	231,282	236,301	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	256.8	102.8	187.3	249.7	154.2	130.5	161.4	1,028.5	3,078.5	1,621.0	939.4	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	98,842	108,017	120,691	132,765	140,569	150,651	165,262	166,575	160,706	163,456	163,456	Deposits excluded from broad money
Jorezident	8,440.3	8,318.7	10,042.9	9,706.5	16,564.1	16,539	23,890	23,874	23,853	31,938	31,925	Nonresidents
Qeveria qendrore	8,966.2	10,465.6	12,887.1	22,239.2	16,600.5	25,807	24,437	29,715	28,774	25,411	23,767	Central government
Korporata të tjera depozituese	80,810.0	88,570.2	97,054.7	100,031.3	106,310.9	107,347	115,896	112,030	107,114	105,243	113,825	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	14.9	20.5	37.2	62.5	85.0	86	95	94	95	93	93	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	610.4	641.5	669.2	725.4	1,008.8	871	945	861	871	770	764	Other resident sectors
Huatë	5,921	4,852	3,871	2,919	2,294	2,294	2,153	2,103	2,060	2,078	2,063	-
Jorezidentët	5,920.6	4,852.0	3,870.7	2,919.3	2,294.2	2,294	2,153	2,103	2,060	2,078	2,063	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	936.4	1,064.3	1,680.5	1,828.3	886.8	1,096	1,760	1,649	289	525	410	Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,439.5	7,647.1	7,557.9	7,287.5	7,753.2	8,074	8,209	8,395	8,152	8,294	8,186	SDR allocation
Aksione dhe Instrumenta të tjerë	52,249.7	59,992	59,947.5	45,971.3	55,786.1	63,516	65,516	68,752	65,175	67,629	64,333	Shares and other equity